



## Dhimbjet e lindjes - Fletë informacioni për lindjen me operacion (prerja cezariane)

Qëllimi i kësaj broshure është t'ju tregojë se çfarë të prisni nëse/kur i nënshtroheni lindjes me operacion.



### Kur mund të më duhet lindja me operacion dhe çfarë duhet të

### pres? Kur e zgjidhni ju (e planifikuar)

Ky është rasti kur operacioni planifikohet paraprakisht.

#### Përgatitja:

Përpara operacionit:

- Do të takoni maminë, obstetrin dhe anezestistin për t'ju shpjeguar çfarë duhet të prisni
- Gjithashtu do të kryeni ekzaminime rutinë dhe analiza gjaku për të kontrolluar që nuk jeni anemike dhe për të konfirmuar grupin tuaj të gjakut në rast se keni nevojë për një transfuzion gjaku gjatë ose pas operacionit tuaj
- Do t'ju jepin disa tableta për të zvogëluar aciditetin në stomak dhe për të parandaluar që të ndiheni keq
- Do t'ju jepet informacion në lidhje me kohën kur duhet të ndaloni të ngrënë dhe të pirë para operacionit

Në disa njësi të maternitetit, gratë që i nënshtrohen operacionit do të jenë në atë që quhet një Program i Rimëkëmbjes së Shpejtë, i cili është një qasje moderne për të ndihmuar njerëzit të rikuperohen më shpejt pasi t'i jenë nënshtuar operacionit.

#### Ditën e operacionit:

Kur të shtroheni në maternitet, do të bëheni gati për sallën e operacionit:

- Do t'ju jepin shiritat për emrat dhe çorape të veçanta për të zvogëluar rrezikun e formimit të mpiksjes së gjakut në këmbë
- Ne do të kryejmë kontrolle rutinë
- Ne do të kontrollojmë që keni formularin zyrtar të pëlqimit
- Ne do të kontrollojmë që të keni marrë tabletat e para mjekimit dhe kohën kur keni ngrënë ose pirë diçka
- Ju dhe partnerit tuaj në lindje do t'ju jepin veshjet e veçanta për sallën e operacionit

Në këtë fazë do të merrni përgjigje për çdo pyetje që keni në lidhje me operacionin.

### Lindje urgjente (e paplanifikuar)

Ky është rasti kur obstetri juaj rekomandon një lindje me operacion, zakonisht ndodh kur jeni tashmë në fazën e dhimbjeve të lindjes. Nëse është shumë urgjente (zakonisht sepse ka një problem të papritur me beben), atëherë disa nga përgatitjet që do të bënim normalisht mund të ndryshohen ose edhe të mos bëhen fare.

#### Kush do të jetë në sallën e operacionit?

Ka shumë njerëz që punojnë në sallën e operacionit:

- Do të takoni maminë, obstetrin dhe anezestistin për t'ju shpjeguar çfarë duhet të prisni
- Gjithashtu do të kryeni ekzaminime rutinë dhe analiza gjaku për të kontrolluar që nuk jeni anemike dhe për të konfirmuar grupin tuaj të gjakut në rast se keni nevojë për një transfuzion gjaku gjatë ose pas operacionit tuaj
- Do t'ju jepin disa tableta për të zvogëluar aciditetin në stomak dhe për të parandaluar që të ndiheni keq
- Do t'ju jepet informacion në lidhje me kohën kur duhet të ndaloni të ngrënë dhe të pirë para operacionit

Në varësi të llojit të anezestisë që do t'ju administrohet, partneri juaj mund ose mund të mos lejohet të jetë me ju në sallën e operacionit (shih më poshtë).



## Çfarë ndodh kur hyj në sallë?

Një anëtar i personelit do t'ju fusë në sallë. Nëse nuk ju është vënë tashmë, në dorë ose në krah do t'ju vihet një vigon në mënyrë që anestezisti t'ju japë lëngje dhe ilaçe. Ekipi i sallës do të lidhë disa pajisje monitorimi rutinë në trupin, krahun dhe gishtin tuaj- këto nuk shkaktojnë dhimbje. Pastaj ekipi i sallës do t'ju njohë me ekipin dhe do të kryejë një listëkontrolli rutinë për sigurinë të rekomanduar nga OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) para se të nisë ndërhyrja.

## Anestezia: llojet e anestezeve

Ekzistojnë dy lloje kryesore anestezie: ose do të rriini zgjuar (anestezia lokale) ose në gjumë (anestezia e përgjithshme).

## Anestezia e pjeshme

### Çfarë është?

Shumica e nënave zgjedhin të jenë zgjuar gjatë lindjes, gjë që zakonisht është më e sigurt për ju dhe fëmijën tuaj dhe ju lejon juve dhe partnerit të përjetoni lindjen së bashku.

#### Spinale:

- Kjo është anestezia më e përdorur zakonisht. Ajo kryhet me injektimin e anestezisë lokale dhe qetësuesve të fortë të dhimbjeve në kuriz me një gjilpërë shumë të hollë. Ilaçi futet në lëngun ku qëndrojnë nervat tuaja, të cilat normalisht i japin ndjesi barkut dhe këmbëve tuaja.

#### CSE (epidurale spinale e kombinuar):

- Kjo është kur anestezia spinale kombinohet me atë epidurale.

#### "Rimbushja epidurale":

- Mund të ndodhë të keni nevojë për ndërhyrje kirurgjikale në fazën e dhimbjeve të lindjes dhe mund t'ju jetë bërë anestezia epidurale.
- Nëse epiduralja ka funksionuar mirë, anestezisti do të injektojë ilaçe në epiduralen tuaj.

### Çfare duhet të prisni?

- Do t'ju kërkohet të uleni, duke u shtrirë mbi një jastëk ose të shtrihen në ije, duke harkuar shpinën.
- Anestezisti do të spërkatë shpinën tuaj me një spraj të ftohtë sterilizues dhe do të injektojë një anestetik lokal në pjesën e poshtme të shpinës për të mpirë lëkurën tuaj.
- Nga kjo pikë e tutje, ju thjesht duhet të ndjeni presion ose shtytje në shpinë. Teksa anestetiku injektohet, mund të ndjeni pickime që zbresin përgjatë këmbës, zakonisht nuk është asgjë për t'u shqetësuar, por duhet t'ia tregoni anestezistit nëse ndodh.
- Procedura do të zgjasë disa minuta, por mund të zgjasë më shumë nëse është e vështirë të gjendet pozicioni i duhur për gjilpërën.
- Të ndenjurat dhe këmbët do të fillojnë të ndjehen të ngrohta dhe të rënda ose mund të fillojë ndjesia e pickimit. Anestezisti do të kontrollojë anestetikun me një spërkatje të ftohtë para se të fillojë operacionin.
- Mund të ndodhë që presioni i gjakut të bjerë me injeksionin dhe kjo mund t'ju bëjë të ndjeheni keq. Ju lutemi përmendeni këtë pasi mund të trajtohet shumë lehtë me ilaçe.

## Anestezia e përgjithshme

### Çfarë është?

Ju do të jeni në gjumë teksa mjeku obstetër kryen prerjen cezariene. Ndërhyrja kirurgjikale mund të nevojitet për rastet urgjente kur bebja duhet të lindë me shumë urgjencë ose nëse anestezia e pjeshme nuk është e përshtatshme për ju (për shkak të çrregullimeve të mpiksjes së gjakut ose anomalive në shpinë), nëse ndjeni dhimbje gjatë operacionit ose nëse preferoni të jenë në gjumë.

### Çfare duhet të prisni?

Shumica e përgatitjeve janë të ngjashme me ato për një anestetiz të pjeshme. Ju do të shtrihen në tryezën e operacionit e cila është anuar në të majtë. Do t'ju kërkohet të pini një ilaç kundër aciditetit dhe mbi fytyrën tuaj do të vendoset një maskë oksigjeni që puthitet mirë. Anestezisti do të injektojë ilaçin në vigon. Pak para se të flini, do të ndjeni një presion të lehtë në qafë.

## Çfarë ndodh gjatë operacionit dhe sa kohë do të duhet?

Nëse jeni zgjuar gjatë operacionit, mund të ndjeni tërheqje dhe trysni, por nuk do të ndjeni dhimbje. Disa gra e kanë përshkruar atë ndjesi "sikur dikush lante enët brenda barkut tim". Anestezisti do t'ju flasë gjatë operacionit dhe do t'ju japë më shumë qetësues dhimbjesh nëse është e nevojshme. Ndonjëherë kërkohet anestezia e përgjithshme. Lindja e foshnjës mund të zgjasë vetëm disa minuta, por do të duhet më shumë nëse keni bërë operacione të mëparshme. Foshnja do të thahet dhe ekzaminohet nga mamia dhe/ose pediatri. Nëse gjithçka është në rregull, ne inkurajojmë kontaktin lëkurë me lëkurë dhe do t'ju ndihmojmë për ta bërë. Pas lindjes, mjeku obstetër do të heqë placentën dhe do të mbyllë plagën. Kjo mund të zgjasë rreth 30 minuta ose më shumë për t'u përfunduar.

## Pas prerjes cezariene dhe lehtësimit të dhimbjeve

Kur del anestezia mund t'ju jepet një supostë për të lehtësuar dhimbjen. Nëse keni pasur anestezia të pjeshme, ilaçet që keni marrë në shtyllën kurrizore ose CSE ose rimbushja epidurale do të zgjasin për disa orë. Nëse keni pasur anestezia të përgjithshme, mund t'ju jepen anestetikë lokalë për të mpirë disa nerva në barkun tuaj. Pas mbarimit të operacionit, ju dhe fëmija juaj do të zhvendoseni në një shtrat në zonën e rikuperimit për monitorim rutinë për afro 30 minuta. Do të inkurajoheni të pini pijen tuaj të parë në këtë pikë nëse nuk ndiheni keq. Mamia gjithashtu mund t'ju japë tableta, p.sh. paracetamol dhe një antiinflamator, për shembull ibuprofen.

Mund të merrni më shumë informacion për llojet e ndryshme të anestezeve, përfitimet dhe rreziqet e tyre në: [www.labourpains.com](http://www.labourpains.com). Ju lutemi shikoni edhe broshurën tonë "Informacione për partnerët në lindje për lindjen me operacion".

